**LIGJ**
**Nr. 23/2016**

# PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR MBROJTJEN SHOQËRORE DHE TË PROTOKOLLIT PËRFUNDIMTAR TË SAJ

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për mbrojtjen shoqërore dhe protokolli përfundimtar i saj, sipas teksteve bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.3.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9475, datë 24.3.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

## MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Republika e Shqipërisë dhe Republika Federale e Gjermanisë,
*me dëshirën për të rregulluar* marrëdhëniet e tyre në fushën e mbrojtjes shoqërore,
ranë dakord si më poshtë vijon:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Përkufizimi i termave**

1) Në këtë marrëveshje, termat e poshtëshënuar përkufizohen si vijon:
1. "Shteti kontraktues"
Republika e Shqipërisë ose Republika Federale e Gjermanisë.
2. "Territori sovran"
Në lidhje me Republikën e Shqipërisë:
Territori sovran i Republikës së Shqipërisë;
Në lidhje me Republikën Federale të Gjermanisë:
Territori sovran i Republikës Federale të Gjermanisë.
3. "Shtetas"

Në lidhje me Republikën e Shqipërisë:

Një shqiptar në kuptim të legjislacionit shqiptar për shtetësinë;

Në lidhje me Republikën Federale të Gjermanisë:

Një gjerman në kuptimin e ligjit themelor për Republikën Federale të Gjermanisë.

4. "Dispozitat ligjore"

Ligjet, dekretet, statutet dhe aktet e tjera të përgjithshme normative, të cilat u referohen atyre degëve të mbrojtjes shoqërore, që mbulohen nga fusha lëndore e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

5. "Autoriteti kompetent"

Në lidhje me Republikën e Shqipërisë:

Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;

Në lidhje me Republikën Federale të Gjermanisë:

Ministria Federale për Punën dhe Çështjet Sociale.

6. "Institucion"

Në lidhje me Republikën e Shqipërisë: institucioni kompetent, detyra e të cilit është zbatimi i dispozitave ligjore të mbuluara nga fusha lëndore e zbatimit të kësaj marrëveshjeje;

Në lidhje me Republikën Federale të Gjermanisë: një institucion, detyra e të cilit është zbatimi i dispozitave ligjore të mbuluara nga fusha lëndore e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

7. "Periudhat e sigurimit"

Periudhat e pagesës së kontributit dhe periudhat e punësimit, të përcaktuara si të tilla sipas dispozitave ligjore përkatëse, si dhe periudha të tjera, të cilat njihen si të tilla në bazë të këtyre dispozitave ligjore.

8. "Pension" ose "përfitime në para"

Një pension ose përfitim tjetër në para, duke përfshirë të gjitha shtesat, kompensimet dhe rritjet në kuptimin e dispozitave ligjore të mbuluara nga fusha lëndore e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

9. "Vendbanim i zakonshëm"

Vendi i qëndrimit faktik, jo i përkohshëm.

2) Termat e tjerë kanë atë kuptim, i cili u përket atyre sipas dispozitave të zbatueshme ligjore të shtetit përkatës kontraktues.

Neni 2

**Fusha lëndore e zbatimit**

1. Kjo marrëveshje u referohet

1) në lidhje me Republikën Federale të Gjermanisë: dispozitave ligjore për

a) sigurimin e pensionit,

b) sigurimin shtesë të korporatës së minatorëve,

c) pensionin e pleqërisë për bujqit;

2) në lidhje me Republikën e Shqipërisë: dispozitave ligjore të skemës së detyrueshme të sigurimeve shoqërore për

a) pensionin e pleqërisë,

b) pensionin e invaliditetit,

c) pensionin familjar.

2. Nëse sipas dispozitave ligjore të një shteti kontraktues janë të plotësuara jo vetëm kushtet për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, por edhe kushtet për zbatimin e një marrëveshjeje tjetër ose të një rregullimi mbishtetëror, atëherë institucioni i këtij shteti kontraktues nuk e merr parasysh marrëveshjen tjetër ose rregullimin mbishtetëror, kur e zbaton këtë marrëveshje.

Neni 3

**Fushë zbatimi personale**

Nëse marrëveshja nuk e parashikon ndryshe, ajo zbatohet për të gjithë personat, për të cilët janë ose kanë qenë të vlefshme dispozitat ligjore të një ose të dyja shteteve kontraktuese, si dhe për persona të tjerë, për sa u përket të drejtave, të cilat rrjedhin nga ata persona.

Neni 4
**Trajtimi i barabartë**

Nëse marrëveshja nuk e parashikon ndryshe, personat e mbuluar nga fusha personale e zbatimit të kësaj marrëveshjeje kanë pozitë të barabartë me shtetasit e shtetit tjetër kontraktues gjatë zbatimit të dispozitave ligjore të këtij shteti kontraktues.

Neni 5
**Pozita e barabartë e vendbanimit të zakonshëm dhe eksportimi i përfitimeve**

Nëse marrëveshja nuk e parashikon ndryshe, dispozitat ligjore kufizuese të një shteti kontraktues, sipas të cilave pretendimet për përfitime ose kryerja e pagesave varen nga vendbanimi i zakonshëm brenda territorit sovran të këtij shteti kontraktues, nuk zbatohen për personat e mbuluar nga fusha personale e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, të cilët vendbanimin e zakonshëm e kanë brenda territorit sovran të shtetit tjetër kontraktues.

PJESA II
DISPOZITAT E ZBATUESHME LIGJORE

Neni 6
**Rregullime të përgjithshme**

1. Nëse marrëveshja nuk e parashikon ndryshe:

a) për një punëmarrës zbatohen vetëm dispozitat ligjore të shtetit kontraktues, brenda territorit sovran të të cilit ai punon faktikisht;

b) për një punëmarrës, i cili është pjesëtar i ekuipazhit fluturues ose shërbyes i një avioni, zbatohen dispozitat ligjore të shtetit kontraktues në të cilin ka selinë shoqëria ajrore;

c) për një punëmarrës, i cili punon zakonisht në bord të një anijeje detare që lundron nën flamurin e një shteti kontraktues, zbatohen dispozitat ligjore të këtij shteti kontraktues.

2. Paragrafi 1 zbatohet përkatësisht edhe për një person të vetëpunësuar.

Neni 7
**Persona të dërguar**

1. Kur një punëmarrës, i cili zakonisht është i punësuar brenda territorit sovran të një shteti kontraktues, dërgohet në kuadër të këtij raporti punësimi nga punëdhënësi i tij, i cili zakonisht kryen një aktivitet të konsiderueshëm fitimprurës në shtetin dërgues, në territorin sovran të shtetit tjetër kontraktues, për të kryer atje një punë për atë punëdhënës, kohëzgjatja e së cilës që më parë është e kufizuar, atëherë gjatë 24 muajve të para të dërgimit vazhdojnë të zbatohen vetëm dispozitat ligjore të shtetit të parë kontaktues, sikur punëmarrësi të ishte i punësuar ende brenda territorit sovran të këtij shteti. Periudha prej 24 muajve mund të kryhet në disa periudha të pjesshme.

2. Për një punëmarrës të dërguar sërish në territorin sovran të shtetit tjetër kontraktues, për të cilën gjatë dërgimeve të mëparshme janë mbushur 24 muaj sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, paragrafi 1 zbatohet vetëm atëherë kur dërgimi i ri kryhet në kuadër të një raporti punësimi me një punëdhënës tjetër ose kur periudha midis mbarimit të dërgimit të fundit dhe fillimit të dërgimit të ri është më e gjatë se 12 muaj.

3. Për një punëmarrës të dërguar në territorin sovran të shtetit tjetër kontraktues, paragrafi 1 do të vlejë për periudhën e mbetur nga 24 muajt, kur ky punëmarrës zëvendëson një punëmarrës të mëparshëm, i cili faktikisht ishte dërguar në këtë vend pune për më pak se 24 muaj.

4. Nëse zbatohen dispozitat ligjore të shtetit dërgues, atëherë duhet që me kërkesë të lëshohet një vërtetim përkatës. Në Republikën e Shqipërisë, ky vërtetim lëshohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Në Republikën Federale të Gjermanisë, ky vërtetim lëshohet nga arka e sigurimit shëndetësor, e cila arkëton kontributet për sigurimin e pensioneve. Në rast se kontributet e sigurimeve shoqërore nuk arkëtohen në arkën e sigurimit shëndetësor ky vërtetim do të lëshohet nga "Deutsche Rentenversicherung Bund".

Neni 8

**Punonjësit e përfaqësive diplomatike dhe konsullore**

1. Kjo marrëveshje nuk e prek zbatimin e Konventës së Vjenës, të datës 18 prill 1961, për Marrëdhëniet Diplomatike dhe të Konventës së Vjenës, të datës 24 prill 1963, për Marrëdhëniet Konsullore.

2. Kur një shtetas i një shteti kontraktues punësohet nga një përfaqësi diplomatike ose konsullore e këtij shteti kontraktues ose nga një pjesëtar i një përfaqësie diplomatike ose konsullore të këtij shteti kontraktues brenda territorit sovran të shtetit tjetër kontraktues, atëherë për të janë të vlefshme si rregull dispozitat ligjore të shtetit, në të cilin ai është i punësuar. Megjithatë, brenda 6 muajve pas fillimit të punës ose pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje ai mund të vendosë për zbatimin e dispozitave ligjore të shtetit të parë kontraktues, të cilat në lidhje me punësimin në fjalë do të vlejnë prej momentit të fillimit të punës ose të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje njëlloj sikur ai të ishte i punësuar atje.

3. Vendimi përkatës duhet t'i deklarohet punëdhënësit, i cili duhet t'ia njoftojë menjëherë arkës kompetente të sigurimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën Federale të Gjermanisë dhe respektivisht Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Neni 9

**Përjashtimet**

1. Me kërkesë të përbashkët të një punëmarrësi dhe punëdhënësit të tij ose me kërkesë të një personi të vetëpunësuar, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese ose institucionet e autorizuara prej tyre, në mirëkuptim me njëri-tjetrin, mund të bien dakord për përjashtime nga rregullimet e kësaj marrëveshjeje mbi dispozitat e zbatueshme ligjore. Kushti paraprak për këtë është që personi në fjalë vazhdon t'u nënshtrohet ose do t'u nënshtrohet dispozitave ligjore të njërit shtet kontraktues. Për të marrë vendim përkatës, duhet të vlerësohen lloji dhe rrethanat e punësimit.

2. Kërkesa duhet të paraqitet në atë shtet kontraktues, dispozitat ligjore të të cilit synohen të zbatohen.

3. Nëse për shkak të një përjashtimi, për të cilin është rënë dakord, nuk zbatohen dispozitat ligjore të shtetit, në të cilin kryhet punësimi, atëherë duhet të lëshohet një vërtetim përkatës. Kur zbatohen dispozitat ligjore shqiptare, ky vërtetim lëshohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Kur zbatohen dispozitat ligjore gjermane, ky vërtetim lëshohet nga "Spitzenverband Bund der Krankenkassen (GKV- Spitzenverband), Deutsche Verbindungsstelle Krankenversicherung - Ausland (DVKA)".

PJESA III

RREGULLIME TË VEÇANTA

Neni 10

**Mbledhja e periudhave të sigurimit dhe llogaritja e pensionit**

1. Për njohjen e së drejtës për përfitime sipas dispozitave të zbatueshme ligjore konsiderohen edhe ato periudha sigurimi, të cilat mund të përllogariten sipas dispozitave ligjore të shtetit tjetër kontraktues dhe nuk i përkasin të njëjtës periudhe sigurimi. Kohëzgjatja e periudhave të sigurimit, të cilat duhet të vlerësohen, orientohet nga dispozitat ligjore të shtetit kontraktues, sipas të cilave janë përmbushur.

2. Nëse e drejta për përfitime kushtëzohet nga periudha të caktuara sigurimi, atëherë do të konsiderohen vetëm periudhat e krahasueshme sipas dispozitave ligjore të shtetit tjetër kontraktues.

3. Llogaritja e pensionit bazohet në dispozitat e zbatueshme ligjore të shtetit përkatës kontraktues, nëse kjo marrëveshje nuk e parashikon ndryshe.

4. Periudhat e sigurimit, të cilat do të merren në konsideratë për bashkimin e periudhave të sigurimit, llogariten vetëm me kohëzgjatjen e tyre faktike.

Neni 11

**Rregullime të veçanta për Republikën Federale të Gjermanisë**

1. Bazë për llogaritjen e krediteve personale të pagesës janë ato kredite të pagesës, të cilat burojnë nga dispozitat ligjore gjermane. Kur bëhet fjalë për pensionin e pleqërisë, për bujqit, shifra e rritjes përbën bazën për llogaritjen e pensionit.

2. Përcaktimi për mbledhjen e periudhave të sigurimit vlen përkatësisht edhe për përfitimet për rehabilitim mjekësor, për pjesëmarrjen aktive në punë, si dhe për përfitimet plotësuese.

3. Periudhat e sigurimit të përmbushura sipas dispozitave ligjore shqiptare, të cilat janë përmbushur në ndërmarrjet e xehetarisë, duke punuar në minierë, vlerësohen në sigurimin e pensioneve të korporatës së minatorëve. Nëse sipas dispozitave ligjore gjermane puna e vazhdueshme në minierë nën tokë ose një punë me status të barabartë me të përbën kusht për pretendim, atëherë institucioni kompetent gjerman i vlerëson ato periudha të sigurimit të përmbushura sipas dispozitave ligjore shqiptare, brenda të cilave është kryer punë e barabartë.

4. Nëse e drejta për përfitime sipas dispozitave ligjore gjermane kushtëzohet nga përmbushja e periudhave të caktuara të sigurimit brenda një periudhe të caktuar, dhe nëse dispozitat ligjore e parashikojnë zgjatjen e kësaj periudhe me rrethana ose me periudha të caktuara të sigurimit, atëherë për zgjatjen do të vlerësohen edhe periudhat e sigurimit sipas dispozitave ligjore shqiptare ose rrethana të krahasueshme në Republikën e Shqipërisë. Rrethana të krahasueshme janë periudhat, brenda të cilave janë paguar pensione invaliditeti ose pleqërie, ose janë akorduar pagesa për shkak të sëmundjes, shtatzënisë, barrëlindjes, papunësisë ose të një aksidenti në punë (me përjashtim të pensioneve për shkak të aksidenteve në punë) sipas dispozitave ligjore shqiptare, si dhe periudhat e edukimit të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë.

5. Nëse për pensionin e pleqërisë për bujqit, akordimi i pagesave të caktuara kushtëzohet nga përmbushja e periudhave të sigurimit në sistemin e posaçëm për bujqit, atëherë për akordimin e këtyre pagesave, periudhat e sigurimit të përmbushura sipas dispozitave ligjore shqiptare vlerësohen vetëm nëse janë përmbushur duke punuar si bujk i vetëpunësuar.

Neni 12

**Rregullime të veçanta për Republikën e Shqipërisë**

1. Bazë për përllogaritjen e pensionit janë periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit shqiptar.

2. Nëse e drejta për përfitim kushtëzohet nga përmbushja e periudhave të sigurimit në një profesion apo punë të caktuar, atëherë periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit gjerman në këtë profesion apo punë të caktuar, do të merren në konsideratë sikur të jenë plotësuar në Shqipëri.

3. Nëse e drejta për përfitime kushtëzohet me përmbushjen e periudhave të sigurimit brenda një periudhe të caktuar, atëherë periudhat e sigurimit të realizuara brenda periudhës së caktuar sipas legjislacionit gjerman, do të konsiderohen sikur janë realizuar në Shqipëri.

PJESA IV

RREGULLIME TË NDRYSHME

KAPITULLI 1

NDIHMË ADMINISTRATIVE DHE JURIDIKE

Neni 13

**Ndihmë administrative dhe juridike, kontrolle mjekësore**

1. Lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore të mbuluara nga fusha lëndore e zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe me zbatimin e vetë marrëveshjes, institucionet e shteteve kontraktuese i japin njëri-tjetrit ndihmë të ndërsjellë në atë mënyrë, sikur t'i zbatonin dispozitat ligjore, që vlejnë për ata vetë. Kjo ndihmë jepet falas.

2. Ndihma e ndërsjellë përfshin edhe kontrollet mjekësore në kuadër të sigurimit të pensioneve. Shpenzimet për kontrollin, për udhëtimin, për humbjen e të ardhurave, për strehimin për qëllim kontrollimi, si dhe pagesa të tjera që u bëhen të tretëve, me përjashtim të shpenzimeve për komunikim, rimbursohen nga institucionet kërkues. Kur kontrolli mjekësor është në interesin e institucioneve të dy shteteve kontraktuese, shpenzimet nuk do të rimbursohen.

3. Institucionet e përmendura në nenin 19, paragrafët 2 dhe 6 të kësaj marrëveshjeje, në kuadër të kompetencave të tyre u transmetojnë njëri-tjetrit dhe personave të prekur ato fakte dhe prova, të cilat janë të nevojshme për t'iu garantuar të drejtat dhe detyrimet, që rrjedhin nga dispozitat ligjore të përmendura në nenin 2 dhe nga kjo marrëveshje.

Neni 14

**Njohja e vendimeve dhe dokumenteve të ekzekutueshme, si dhe vjelja e kontributeve të papaguara**

1. Vendimet e përmbarueshme të gjykatave, si dhe dokumentet e ekzekutueshme të institucioneve ose të autoriteteve të një shteti kontraktues për kontributet dhe kërkesa të tjera në kuadër të fushës lëndore të zbatimit të kësaj marrëveshje njihen në shtetin tjetër kontraktues.

2. Njohja mund të refuzohet vetëm në ato raste kur ajo do të ishte në kundërshtim me rendin publik të shtetit kontraktues, në të cilën kërkohet njohja e vendimit ose dokumentit.

3. Vendimet dhe dokumentet e ekzekutueshme sipas paragrafit 1 do të ekzekutohen në shtetin tjetër kontraktues. Procedura e përmbarimit orientohet nga dispozitat ligjore, të cilat vlejnë në shtetin kontraktues, në territorin sovran të të cilit do të kryhet përmbarimi, lidhur me ekzekutimin e vendimeve dhe dokumenteve përkatëse të lëshuara në këtë shtet.

4. Kërkesat e paraqitura nga institucionet e një shteti kontraktues, të cilat u referohen kontributeve të papaguara, lidhur me ekzekutimin e detyrueshëm, si dhe në procedurën e falimentimit dhe në procedurën e pajtimit në territorin sovran të shtetit tjetër kontraktues kanë përparësi të njëjtë siç e kanë edhe kërkesat përkatëse të një institucioni të këtij shteti kontraktues.

5. Vjelja e kontributeve të papaguara, të cilat kanë të bëjnë me një degë sigurimi të mbuluar nga fusha lëndore e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, bëhet nëpërmjet:

a) Në Republikën Federale të Gjermanisë nëpërmjet:

Sigurimi Gjerman i Pensioneve i landit Rheinland-Pfalz (Deutsche Rentenversicherung Rheinland-Pfalz), Speyer,

Sigurimi Gjerman i Pensioneve – Federata (Deutsche Rentenversicherung Bund), Berlin,

Sigurimi Gjerman i Pensioneve - Korporata e Punonjësve të Hekurudhës dhe e Detarëve (Deutsche Rentenversicherung Knappschaft-Bahn-See), Bochum,

Sigurimi Social për Bujqësinë, Pylltarinë dhe Kopshtarinë (Sozialversicherung für Land-wirtschaft, Forsten und Gartenbau), Kassel;

në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë,

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Tiranë.

Neni 15

**Tarifat**

Përjashtimi nga taksat ose tarifat administrative, duke përfshirë tarifat konsullore ose zbritja e këtyre taksave ose tarifave, e cila parashikohet në bazë të dispozitave ligjore të një shteti kontraktues, si dhe rimbursimi i shpenzimeve për dokumentet, të cilat duhet të paraqiten në zbatim të këtyre dispozitave ligjore, përfshin edhe dokumentet përkatëse, të cilat duhet të paraqiten në zbatim të kësaj marrëveshjeje ose në zbatim të dispozitave ligjore të shtetit tjetër kontraktues, të cilat mbulohen nga fusha lëndore e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 16

**Publikimi i dokumenteve të shkruara, gjuhët zyrtare**

1. Lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe të dispozitave ligjore të mbuluara nga fusha lëndore e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, institucionet e shteteve kontraktuese mund të komunikojnë drejtpërdrejt me njëri-tjetrin, si dhe me personat e prekur dhe me përfaqësuesit e tyre në gjuhët e tyre zyrtare. Dispozitat ligjore për përfshirjen e përkthyesve mbeten të paprekura.

2. Vendimet ose shkresat e tjera mund t'i dërgohen një personi, i cili qëndron në territorin sovran të shtetit tjetër kontraktues, drejtpërdrejt me anë të një letre të zakonshme ose një letre rekomande me vërtetim marrjeje. Kjo vlen edhe për vendimet ose shkresat e tjera që duhet të dërgohen, të cilat nxirren në zbatim të ligjit gjerman mbi kujdesjen për viktimat e luftës dhe në zbatim të atyre ligjeve, të cilat deklarojnë, që ky ligj të zbatohet përkatësisht.

3. Institucionet e shteteve kontraktuese nuk mund të refuzojnë kërkesa dhe dokumente me arsyetimin se janë shkruar në gjuhën zyrtare të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 17

**Trajtimi i barabartë i kërkesave**

1. Kur kërkesa për pagesë në bazë të dispozitave ligjore të një shteti kontraktues ka mbërritur tek institucioni në shtetin tjetër kontraktues, atëherë kërkesa vlerësohet si e paraqitur tek institucioni i shtetit të parë kontraktues. Kjo vlen përkatësisht edhe për kërkesat e tjera, si dhe për deklaratat, informacionet dhe instrumentet ligjore.

2. Institucioni i shtetit kontraktues, në të cilin janë paraqitur kërkesat, deklaratat, informacionet dhe instrumentet ligjore, është i detyruar t'ia transmetojë ato pa vonesë institucionit të shtetit tjetër kontraktues.

3. Një kërkesë për pagesa në bazë të dispozitave ligjore të një shteti kontraktues vlerësohet edhe si kërkesë për një pagesë përkatëse në bazë të dispozitave ligjore të shtetit tjetër kontraktues, kur nga kërkesa del se janë përmbushur periudhat e sigurimit në bazë të dispozitave ligjore të shtetit tjetër kontraktues. Kjo nuk vlen në rastet kur parashtruesi i kërkesës e kërkon shprehimisht shtyrjen e vërtetimit të pretendimeve lidhur me pensionin e pleqërisë në bazë të dispozitave ligjore të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 18

**Mbrojtja e të dhënave personale**

Kur në bazë të kësaj marrëveshjeje dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm transmetohen të dhëna personale, atëherë vlejnë përcaktimet e mëposhtme, duke marrë parasysh dispozitat ligjore, të cilat vlejnë për secilën palë kontraktuese:

1. Marrësi, kur i kërkohet, e njofton institucionin transmetues për përdorimin e të dhënave të transmetuara dhe për rezultatet e arritura nga kjo.

2. Përdorimi i të dhënave nga marrësi lejohet vetëm për qëllimet e caktuara në këtë marrëveshje dhe me kushtet e parashikuara nga institucioni transmetues. Më tej, përdorimi i tyre lejohet për parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale jashtëzakonisht të rënda, si dhe për mbrojtjen kundër rreziqeve të konsiderueshme për sigurinë publike, kur autoriteti i shtetit transmetues është shprehur dakord me këtë përdorim. Pa miratimin paraprak të institucionit kompetent të shtetit transmetues, përdorimi për qëllime të tjera lejohet vetëm kur është i domosdoshëm për mbrojtjen kundër një rreziku urgjent, e cila ekziston në rastin konkret për jetën, pacenueshmërinë fizike ose lirinë personale të një individi ose për vlera të konsiderueshme pasurore dhe kur ka rrezik urgjent. Në këtë rast është e domosdoshme që të kërkohet pa vonesë miratimi i mëpasshëm i ndërrimit të qëllimit nga autoriteti kompetent i shtetit transmetues. Nëse miratimi refuzohet, atëherë nuk lejohet përdorimi i mëtejshëm i informacioneve për qëllimin tjetër; dëmi i shkaktuar nga përdorimi i informacionit për një qëllim tjetër duhet të kompensohet.

3. Institucioni transmetues është i detyruar të kujdeset për saktësinë e të dhënave, që do të transmetohen, si dhe për domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin lidhur me qëllimin për të cilin ato transmetohen. Në këtë kuadër duhet të respektohen dispozitat ndaluese të legjislacionit të brendshëm

të secilit shtet në lidhje me transmetimin e të dhënave. Transmetimi i të dhënave nuk bëhet kur institucioni transmetues ka arsye të supozojë se një veprim i tillë do të ishte në kundërshtim me qëllimin e një ligji brendashtetëror ose kur do të dëmtoheshin interesat e personit të prekur, të cilat duhet të mbrohen. Nëse rezulton se janë transmetuar të dhëna të pasakta ose të dhëna, që nuk duhej të transmetoheshin, atëherë duhet të njoftohet menjëherë institucioni marrës. Ky institucion është i detyruar t'i korrigjojë ose t'i shuajë menjëherë të dhënat në fjalë.

4. Institucioni marrës duhet ta informojë personin e prekur lidhur me mbledhjen e të dhënave tek institucioni transmetues. Informacioni i tillë mund të mos i jepet personit të prekur, kur nga analiza përkatëse rezulton se interesi publik për të mos e dhënë informacionin ka përparësi në raport me interesin e personit të prekur për t'u informuar.

5. Personi i prekur, kur paraqet kërkesë përkatëse, duhet të informohet për të dhënat e transmetuara rreth personit të tij, si dhe për qëllimin e parashikuar të përdorimit të tyre. Në këtë kontekst vlen edhe pika 4, fjalia e dytë. Përveç kësaj, e drejta e personit të prekur për t'u informuar për të dhënat rreth personit të tij orientohet nga e drejta e brendshme të atij shteti kontraktues, në territorin sovran të të cilit kërkohet ky informacion.

6. Kur dikush dëmtohet në mënyrë të paligjshme si rezultat i transmetimit të të dhënave sipas kësaj marrëveshjeje, marrësi përgjigjet për këtë në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm. Në raportin e tij me të dëmtuarin, ai nuk mund të shfajësohet duke pohuar se dëmi është shkaktuar nga institucioni transmetues. Nëse institucioni marrës paraqet kompensim për një dëm të shkaktuar nga përdorimi i të dhënave të transmetuara në mënyrë jo të drejtë, atëherë institucioni transmetues ia rimburson institucionit marrës shumën totale të kompensimit të paguar.

7. Nëse legjislacioni i brendshëm, i cili zbatohet për institucionin transmetues, parashikon afate të veçanta për shuarjen e të dhënave personale të transmetuara, institucioni transmetues e njofton marrësin për këtë. Pavarësisht nga këto afate, të dhënat personale të transmetuara duhet të shuhen, sapo ato të mos nevojiten më për qëllimin, për të cilin ishin transmetuar.

8. Institucioni transmetues dhe marrësi kanë detyrimin që ta dokumentojnë transmetimin dhe marrjen e të dhënave personale.

9. Institucioni transmetues dhe marrësi kanë detyrimin që t'i mbrojnë në mënyrë efektive të dhënat personale të transmetuara nga aksesi i paautorizuar, ndryshimi i paautorizuar dhe publikimi i paautorizuar.

## KAPITULLI 2
## ZBATIMI DHE INTERPRETIMI I KËSAJ MARRËVESHJEJE

### Neni 19
### **Marrëveshjet e zbatimit dhe autoritetet ndërlidhëse**

1. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese mund të lidhin marrëveshjet e nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje caktohen institucionet e mëposhtme ndërlidhëse:

1. Në Republikën Federale të Gjermanisë

a) për sigurimin e pensioneve:

Sigurimi Gjerman i Pensioneve i landit Rheinland-Pfalz (Deutsche Rentenversicherung Rheinland-Pfalz), Speyer,

Sigurimi Gjerman i Pensioneve – Federata (Deutsche Rentenversicherung Bund), Berlin,

Sigurimi Gjerman i Pensioneve - Korporata e Punonjësve të Hekurudhës dhe e Detarëve (Deutsche Rentenversicherung Knappschaft-Bahn-See), Bochum,

b) për sigurimin shtesë të korporatës së minatorëve:

Sigurimi Gjerman i Pensioneve pör Saarland-in (Deutsche Rentenversicherung für das Saarland), Saarbrücken,

c) për pensionin e pleqërisë për bujqit:

Sigurimi Social për Bujqësinë, Pylltarinë dhe Kopshtarinë (Sozialversicherung für Land-wirtschaft, Forsten und Gartenbau), Kassel;

d) në rastet kur institucionet ligjore të sigurimit shëndetësor janë të përfshirë në zbatimin e kësaj marrëveshjeje,

Asociacioni Qendror Federal i Shoqërive të Sigurimit Shëndetësor– Dikasteri Ndërlidhës Gjerman për Sigurimin Shëndetësor Jashtë Vendit (Spitzenverband Bund der Krankenkassen (GKV-Spitzenverband), Deutsche Verbindungsstelle Krankenversicherung – Ausland (DVKA), Bonn;

2. Në Republikën e Shqipërisë

a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Tiranë;

b) Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë.

3. Lidhur me klasifikimin e një institucioni rajonal brenda Sigurimit Gjerman të Pensioneve, përgjegjësinë për të gjitha procedurat përfshirë vlerësimin dhe kryerjen e pagesave e ka Deutsche Rentenversicherung Rheinland-Pfalz, Speyer, nëse:

1) janë përmbushur ose duhet të llogariten periudhat e sigurimit sipas dispozitave ligjore gjermane dhe shqiptare; ose nëse

2) personi, i cili ka të drejtë të marrë pagesë, e ka vendbanimin e zakonshëm në territorin sovran të Republikës së Shqipërisë; ose nëse

3) personi, i cili ka të drejtë të marrë pagesë, e ka vendbanimin e zakonshëm jashtë shteteve kontraktuese.

Lidhur me pagesat për rehabilitim mjekësor dhe pjesëmarrje aktive në punë, kjo vlen vetëm kur pagesat në fjalë kryhen në kuadër të një procedure pensionesh në vazhdim.

4. Institucionet ndërlidhëse dhe institucionet e autorizuara nga autoritetet kompetente sipas nenit 9 të kësaj Marrëveshjeje kanë detyrimin që në kuadër të kompetencave të tyre t'i informojnë në përgjithësi personat e prekur për të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas kësaj marrëveshjeje.

5. Institucionet ndërlidhëse autorizohen që me pjesëmarrjen e autoriteteve kompetente në kuadër të kompetencave të tyre të merren vesh për masat administrative të nevojshme dhe efikase, përfshirë procedurën për kryerjen dhe rimbursimin e përfitimeve në para.

6. Paragrafi 5 vlen përkatësisht edhe për institucionet e autorizuara nga autoritetet kompetente sipas nenit 9 të kësaj marrëveshjeje.

7. Institucionet ndërlidhëse e informojnë çdo vit njëri-tjetrin, duke u bazuar në gjendjen e datës 31 dhjetor, për pagesat e kryera për në territorin sovran e shtetit tjetër kontraktues. Po të jetë e mundur, këto të dhëna duhet të përfshijnë numrin dhe shumën totale të pagesave, të klasifikuara sipas kategorive. Hollësirat do të rregullohen nga institucionet ndërlidhëse.

8. Institucionet ndërlidhëse informojnë njëri-tjetrin lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e dispozitave ligjore, të cilat vlejnë për to dhe mbulohen nga fusha lëndore e zbatimit të kësaj marrëveshje.

Neni 20

**Monedha dhe kurset e këmbimit**

1. Pagesa e pensioneve ose pagesat e tjera në para për përfituesin në territorin sovran të shtetit tjetër kontraktues kryhen drejtpërdrejt.

2. Pagesat në para nga një institucion i një shteti kontraktues për një përfitues, i cili ndodhet në territorin sovran të shtetit tjetër kontraktues, mund të kryhen me monedhën e shtetit të parë kontraktues me efekt çlirues. Në raportin mes institucionit dhe personit, i cili ka të drejtë të marrë pagesë, përcaktues për konvertimin është kursi i këmbimit të ditës, i cili është marrë si bazë gjatë transmetimit të pagesave monetare.

3. Nëse një institucion i një shteti kontraktues duhet të kryejë pagesa për një institucion të shtetit tjetër kontraktues, atëherë këto pagesa duhet të kryhen në monedhën e shtetit të dytë kontraktues.

Neni 21

**Rimbursimet**

Nëse institucioni i një shteti kontraktues ka kryer pagesa në para pa pasur të drejtë, atëherë shuma e paguar padrejtësisht mund të zbritet nga pagesa në favor të institucionit, sipas dispozitave ligjore të

shtetit tjetër kontraktues.

Neni 22
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Sa të jetë e mundur, mosmarrëveshjet mes shteteve kontraktuese për interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhen nga autoritetet kompetente.

2. Në qoftë se një mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet në këtë mënyrë, ajo do të rregullohet nga një komision *ad hoc,* i cili ngrihet me miratimin e të dyja palëve.

PJESA V
RREGULLIMET KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23
**Pretendimet për pagesa në bazë të kësaj marrëveshjeje**

1. Kjo marrëveshje nuk përbën bazën për pretendime lidhur me pagesa për kohën para hyrjes së saj në fuqi.

2. Periudhat e sigurimit të përmbushura para hyrjes në fuqi sipas dispozitave ligjore të shteteve kontraktuese dhe rrethanat e tjera me rëndësi ligjore do të merren parasysh gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

3. Vendimet, të cilat janë marrë para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, nuk janë në kundërshtim me zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

4. Pensionet, të cilat janë caktuar para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, me kërkesë mund të rillogariten, kur ndryshimi del vetëm nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje. Pensionet, të cilat janë caktuar para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, mund të rillogariten edhe zyrtarisht. Në këto raste dita, në të cilën institucioni i një shteti kontraktues fillon procedurën, vlerësohet si dita e paraqitjes së kërkesës në bazë të dispozitave ligjore të shtetit tjetër kontraktues.

5. Nëse rillogaritja sipas paragrafit 4 nuk rezulton në asnjë pension ose nëse rezulton në një pension më të ulët sesa pensioni i paguar në periudhën e fundit para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, atëherë pensioni duhet të paguhet edhe më tej me shumën e deriatëhershme.

Neni 24
**Protokolli përfundimtar**

Protokolli përfundimtar i bashkëlidhur është pjesë e kësaj marrëveshjeje.

Neni 25
**Ratifikimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo marrëveshje ka nevojë për ratifikim. Dokumentet e ratifikimit do të shkëmbehen në XX sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas muajit, në të cilën janë shkëmbyer dokumentet e ratifikimit.

Neni 26
**Koha e vlefshmërisë dhe prishja**

1. Kjo marrëveshje mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar. Secili shtet kontraktues mund ta prishë atë në rrugë diplomatike me shkrim, deri në datën 30 shtator të një viti kalendarik. Prishja bëhet e efektshme më 1 janar të vitit kalendarik pas prishjes.

2. Në rast se kjo marrëveshje shfuqizohet për shkak të njoftimit për prishjen, dispozitat e saj lidhur me pretendimet për pagesë, të fituara deri në atë moment, do të vazhdojnë të zbatohen. Dispozitat kufizuese për përjashtimin e një pretendimi apo për pezullimin ose ndërprerjen e pagesave për shkak të vendbanimit të zakonshëm jashtë vendit nuk do të merren parasysh për këto pretendime.

Bërë në Tiranë, më 23.9.2015, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

**PROTOKOLLI PËRFUNDIMTAR**
I MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Mbrojtjen Shoqërore, personat e autorizuar të të dyja shteteve kontraktuese deklarojnë se kanë rënë dakord për sa vijon:

1. Për nenin 1, paragrafi 1, pika 5 e Marrë-veshjes:

Me autoritet kompetent do të nënkuptohet edhe çdo ministër ose ministri tjetër të cilëve në të ardhmen mund t'u kalojë përgjegjësia për fushën lëndore të kësaj Marrëveshje.

2. Për nenin 1, paragraf 1, pika 9 e Marrë-veshjes:

Vendbanim i zakonshëm rezulton nga qëndrimi faktik, i ligjshëm, i cili synohet të jetë i përhershëm, si dhe nga qendra e aktivitetit jetësor.

3. Për nenin 2, paragrafi 1, pika 1, germa "b" e Marrëveshjes:

Rregullimet e veçanta të Marrëveshjes (pjesa III) nuk vlejnë për sigurimin shtesë të korporatës së minatorëve, i cili ekziston në Republikën Federale të Gjermanisë.

4. Për nenin 2, paragrafi 2 i Marrëveshjes:

a) Pavarësisht nga neni 2, paragrafi 2:

- institucionet gjermane, për sa të jetë e nevojshme, marrin parasysh edhe periudhat e sigurimit të një personi, të cilat janë përmbushur në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, në një shtet tjetër kontraktues të Marrëveshjes për Hapësirën Ekonomike Evropiane ose në Zvicër; dhe
- institucionet e të dyja shteteve kontraktuese, për sa të jetë e nevojshme, marrin parasysh edhe periudhat e sigurimit të një personi, të cilat janë përmbushur në një shtet të tretë, me të cilin të dyja shtete kontraktuese kanë lidhur një marrëveshje për mbrojtjen shoqërore.

b) Në lidhje me Republikën Federale të Gjermanisë, neni 2, paragrafi 2 nuk vlen nëse marrëveshja ose rregullimi mbishtetëror tjetër përmban dispozitat për sigurimin sipas të cilave periudhat e sigurimit janë përfundimisht në ngarkim të një shteti ose nuk janë më në ngarkim të tij.

5. Për nenin 4 të Marrëveshjes:

a) Dispozitat ligjore të një shteti kontraktues, të cilat garantojnë bashkëpunimin e të siguruarve dhe të punëdhënësve në organet e vetadministrimit të institucionit dhe të shoqatave të institucioneve, si dhe në juridiksionin e mbrojtjes shoqërore, mbeten të pacenuara;

b) Lidhur me Republikën Federale të Gjerma-nisë, dispozitat për detyrimin e sigurimit në marrëveshjet ndërkombëtare ose në të drejtën ndërkombëtare mbeten të pacenuara;

c) Personat me vendbanim të zakonshëm jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, të cilët kanë shtetësinë e një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, të një shteti tjetër kontraktues të Marrëveshjes për Hapësirën Ekonomike Evropiane ose të Zvicrës, kanë të drejtën të sigurohen vullnetarisht në Sigurimin Gjerman të Pensioneve vetëm sipas Rregullores së Komunitetit Evropian nr. 883/2004;

d) Shtetasit shqiptarë me vendbanim të zakonshëm jashtë territorit sovran të Republikës Federale të Gjermanisë kanë të drejtën të sigurohen vullnetarisht në Sigurimin Gjerman të Pensioneve, nëse për të kanë përmbushur periudha të sigurimit prej jo më pak se 60 muaj. Kjo vlen përkatësisht edhe për refugjatët në kuptimin e nenit 1 të Marrëveshjes së Kombeve të Bashkuara, të datës 28 korrik 1951, mbi pozitën juridike të refugjatëve dhe të protokollit të datës 31 janar 1967, mbi pozitën juridike të refugjatëve, si dhe për personat pa shtetësi në kuptimin e nenit 1 të Marrëveshjes, të datës 28 shtator 1954, mbi pozitën juridike të personave pa shtetësi me vendbanim të zakonshëm në territorin sovran të Republikës së Shqipërisë. Për personat e tjerë, të cilët mbulohen nga fusha personale e zbatimit të marrëveshjes, neni 4 nuk vlen për sigurimin vullnetar në Sigurimin Gjerman të Pensioneve. Dispozitat më të favorshme ligjore të brendshme mbeten të pacenuara;

e) Dispozitat ligjore të shteteve kontraktuese mbi detyrimin për sigurim të një personi zakonisht të punësuar në bordin e një anije detare mbeten të paprekura.

6. Për nenin 5 të Marrëveshjes:

a) Personat me vendbanim të zakonshëm në territorin sovran të Republikës së Shqipërisë marrin një pension në bazë të dispozitave ligjore gjermane për shkak të invaliditetit vetëm në rastin kur kjo e drejtë për të përfituar ekziston, pavarësisht nga gjendja përkatëse e tregut të punës;

b) Dispozitat ligjore gjermane për përfitimet nga periudhat e sigurimit, të cilat nuk ishin kryer në territorin sovran të Republikës Federale të Gjermanisë, dhe për përfitimet për periudhat e sigurimit, të cilat mund të llogariten sipas ligjit për pensionet e huaja, mbeten të pacenuara;

c) Dispozitat ligjore gjermane mbi përfitimet për rehabilitim mjekësor, për pjesëmarrjen aktive në punë, si dhe për përfitimet plotësuese nga institucionet të sigurimit të pensionit dhe të pensionit të pleqërisë për bujqit mbeten të pacenuara;

d) Dispozitat ligjore gjermane, të cilat e parashikojnë pezullimin e pretendimeve nga sigurimi i pensionit për personat, të cilët nëpërmjet qëndrimit të tyre jashtë vendit i shmangen procedimit penal kundër tyre, mbeten të pacenuara.

7. Për nenet 6, 7 dhe 9 të Marrëveshjes:

a) Kur për një person sipas neneve 6, 7 dhe 9 të Marrëveshjes, zbatohen dispozitat ligjore gjermane, lidhur me këtë punësim gjejnë zbatim në të njëjtën mënyrë për të dhe për punëdhënësin e tij vetëm dispozitat ligjore gjermane për sigurimin shëndetësor, sigurimin për përkujdesje shëndetësore dhe sigurimin ndaj aksidenteve, si dhe për detyrimin e sigurimit në bazë të së drejtës së nxitjes së punësimit (sigurimi i papunësisë) njëlloj sikur puna të ishte kryer në Republikën Federale të Gjermanisë.

b) Kur për një person sipas neneve 6, 7 dhe 9 të marrëveshjes zbatohen dispozitat ligjore shqiptare, lidhur me këtë punësim gjejnë zbatim në të njëjtën mënyrë për të dhe për punëdhënësin e tij vetëm dispozitat ligjore shqiptare për sigurimin shëndetësor, sigurimin ndaj aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, sigurimin e sëmundjes, sigurimin për barrëlindje dhe sigurimin e papunësisë, njëlloj sikur puna të ishte kryer në Republikën e Shqipërisë. Në këtë rast, dispozitat ligjore gjermane për përkujdesjen e pleqërisë nuk gjejnë zbatim.

8. Për nenin 7 të Marrëveshjes:

a) Nuk konsiderohet dërgim në shtetin tjetër kontraktues, veçanërisht kur:

aa) puna e punëmarrësit të dërguar nuk përputhet me fushën e veprimtarisë së punëdhënësit në shtetin dërgues;

bb) personi i punësuar me qëllim dërgimi në këtë kohë nuk e ka vendbanimin e zakonshëm në shtetin dërgues.

b) Për personat, të cilët në ditën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes kanë qenë të dërguar, periudha prej 24 muajsh fillon në këtë ditë.

c) Punëdhënësi kryen një aktivitet të konsiderueshëm nëse në vendin ku ushtron zakonisht aktivitetin e tij realizon normalisht 25% të xhiros vjetore ose mban të punësuar 25% të punonjësve.

d) Nëse dërgimi i ri kryhet në kuadrin e një marrëdhënie punësimi me një punëdhënës tjetër, neni 7, paragrafi 1, zbatohet nëse punëmarrësi ka punuar në vendin dërgues me punëdhënësin tjetër të paktën 2 muaj para dërgimit të ri.

9. Për nenin 9 të Marrëveshjes:

Për një përjashtim mund të bihet dakord në mënyrë të veçantë lidhur me një punëmarrës, i cili vihet në dispozicion përkohësisht për më shumë se dy muaj brenda vitit kalendarik te një shoqëri ku punëdhënësi i tij zotëron pjesë në kapital, e cila e ka selinë në territorin sovran të shtetit tjetër kontraktues dhe gëzon personalitet juridik të pavarur dhe për këtë periudhë pune paga është në ngarkim të shoqërisë ku punëdhënësi i tij zotëron pjesë në kapital.

10. Për nenin 23 të Marrëveshjes:

Nëse paraqitet një kërkesë për pension vetëm mbi bazën e zbatimit të kësaj Marrëveshje brenda 12 muajve që ka hyrë në fuqi atëherë pensioni do të fillojë:

a) sipas dispozitave ligjore gjermane në muajin kalendarik, në fillim të të cilit u përmbushën kushtet, sidoqoftë jo më parë se data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje;

b) sipas dispozitave ligjore shqiptare në ditën në të cilën janë përmbushur kushtet, sidoqoftë jo më

parë se data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.